

Financuar nga
**THE
SIGRID
RAUSING
TRUST**



BUXHETIMI I PËRGJEGJSHËM GJINOR

Analiza e Dëgjimeve Buxhetore në Komunat nga Perspektiva Gjinore

(Podujevë, Shtime dhe Dragash)

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:



Ky publikim është mundësuar në kuadër të mbështetjes organizative të Fondit të Grave të Kosovës (FGK), përmes Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) dhe është financuar nga Sigrid Rausing Trust (SRT).

Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Sundimi i Demokracisë në Kosovë (SDK) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e SRT apo RrGK.

Përmbajtja:

Përmbledhje Ekzekutive	4
Metodologjia:	6
Analiza e Gjendjes	8
Baza Ligjore dhe Strategjitë.....	8
Raportet dhe evidencat.....	9
Vlerësimi i Proceseve Buxhetore	12
Përfaqësimi i grave pozitave udhëheqëse politike	13
Pasqyrimi i përbërjes së Kuvendeve Komunale	13
Punësimi, Pagat dhe Subvencionet në Komunën e Podujevës	14
Punësimi, Pagat dhe Subvencionet në Komunën e Shtimes	16
Punësimi, Pagat dhe Subvencionet në Komunën e Dragashit	17
Krahasimi mes Komunave	21
Analiza e Dëgjimeve Buxhetore	26
Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinatorë - Podujevë.....	26
Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator - Shtime	28
Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator - Dragash.....	30
Konkluzionet.....	32
Rekomandimet	32
Lista e Referencave.....	34

Përmbledhje Ekzekutive

Ky dokument analizon procesin e zhvillimit e buxhetit në tri komuna: Podujevë, Shtime dhe Dragash, duke u fokusuar në mënyrën se si këto komuna kanë zhvilluar dëgjimet buxhetore dhe politikatat për barazinë gjinore. Analiza është bazuar në katër qasje kryesore: i. përgatitjen, zhvillimin e takimeve dhe dëgjimeve për BPGJ; ii. zhvillimi i BPGJ në hartimin e buxhetit; iii. ndikimin e BPGJ në shtojcat e buxhetit dhe iv. vlerësimin e adresimit të kërkesave nga gratë gjatë këtyre dëgjimeve. Këto qasje kanë mundësuar një pasqyrë të plotë të përfshirjes gjinore në proceset e buxhetimit dhe kanë ndihmuar në identifikimin e nevojave dhe mundësive për përfshirjen e grave në këto procese.

Për këtë Sundimi i Demokracisë në Kosovë, i mbështetur nga Rrjeti i Grave të Kosovës dhe financuar nga The Singrid Rousing Trust, ka mbështetur komunitatet e përfshira në tri dimensione: i. në planifikimin dhe përgatitjen e dëgjimeve të fokusuara me gratë; ii. duke ofruar informacion mbi procesin e hartimit të buxhetit me perspektivë gjinore dhe iii. duke ju ofruar një pasqyrim mbi rezultatet e pjesëmarrjes në planifikimin e buxhetit. Megjithatë, konsiderohet se procesi i dëgjimeve buxhetore në përgjithësi, e në veçanti sa i përket Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor, ka mangësi evidente, nisur nga planifikimi, vlerësimi i buxhetit nga perspektiva gjinore e deri tek adresimi i kërkesave dhe nevojave.

Ajo çka mund të konstatohet qartë është se pjesëmarrja e grave në dëgjimet buxhetore mbetet ende e ulët, në mesataren e tri komunave del se 33% të pjesëmarrësve janë gra (*Podujeva, 15%; Shtime, 9% dhe Dragashi 58%*). Edhe për kundër se komunitatet, kanë pasur vullnet për të ndërmarrë iniciativë në zgjerimin e pjesëmarrjes, mungesa e një plani të shtrirjes po e pengon këtë proces.

Megjithatë, vërehet se përfshirja e grave në dëgjime buxhetore, përtej që siguron gjithpërfshirje, ofron një perspektivë më sociale sa u përket, politikave të financimit në arsim, shëndetësi, shërbime sociale, zhvillim ekonomik dhe siguri publike. Po ashtu fokus të shtuar ka pasur edhe në përmirësimin e shërbimeve publike si transporti, bartja e fëmijëve, furnizimi me ujë, ndalesat afër shkollave. E ndjeshëm dallon edhe për nga kërkesat për investime kapitale, ku ato marrin më tepër karakter më publik, si parqet, ndriçimi dhe hapësirat kulturore.

Kjo pjesëmarrje e ulët tregon për një angazhim të kufizuar të grave në proceset vendimmarrëse për buxhetin. Për të përmirësuar këtë situatë, komunitatet duhet të ndërmarrin hapa për të inkurajuar pjesëmarrjen më të madhe të grave. Kjo mund të arrihet duke krijuar mundësi dhe platforma për angazhimin e grave nga organizatat lokale, shoqatat dhe sektorët e tjerë që mund të kontribuojnë me kërkesa dhe propozime për buxhetin komunal.

Në lidhje me përfaqësimin gjinor në pozitat politike, edhe pse komuna e Podujevës ka bërë përparime të dukshme në përfaqësimin e grave në pozita politike, me një përfaqësim prej 42.85%, përfaqësimi i grave në pozita udhëheqëse politike mbetet ende i ulët. Në Shtime dhe Dragash, përfaqësimi i grave është më i ulët, me përqindje prej 28.57% dhe 20% respektivisht. Ky përfaqësim i ulët në pozitat politike kërkon ndërhyrje për të siguruar mundësi të barabarta për

gratë që të avancojnë në këto pozita. Kjo, përgjithësisht reflektohet nga nevoja për fuqizimi e grave brenda subjekteve politike.

Problematike, mbetet edhe përfaqësimi i grave në pozita të udhëheqëse administrative. Komunitat duhet të sigurojnë mundësi të barabarta për gratë për avancimin edhe në pozita udhëheqëse, duke zbatuar politika mbështetëse dhe trajnime që ofrojnë mundësi për zhvillimin e aftësive. Gjithashtu, duhet të krijohen masa afirmative dhe infrastrukturë mbështetëse për gratë që janë të angazhuara në aktivitete politike dhe administrative, siç janë mentorimi dhe mbështetje financiare për gratë që dëshirojnë të zhvillojnë karrierën e tyre politike dhe publike.

Pabarazia gjinore në paga është evidente. Gratë janë të përqendruara kryesisht në nivelet e ulëta të pagave. Në komunitat si Podujevë, ka përmirësime të lehta në pagat e grave, por shpërndarja e fondeve mbetet e pabarabartë, dhe gratë vazhdojnë të përballen me barrierat që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë në tregun e punës dhe mundësitë financiare.

Ngjashëm edhe sa u përket ndarjeve buxhetore për investime kapitale dhe subvencione, komunitat duhet të bëjnë një vlerësim të detajuar të shpërndarjes gjinore të fondeve. Kjo duke zhvilluar kriteret të qarta dhe të drejta për priorizim dhe shpërndarje për përfituesit. Duke siguruar kështu që gratë të kenë mundësi të barabarta për të përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet që prekin, apo kufizojnë zhvillimin e tyre, e njëkohësisht mundësitë për të përfituar nga burimet financiare të komunitës. Pjesëmarrja më e madhe e grave në sektorët e zhvillimit ekonomik dhe bujqësor mund të arrihet vetëm nëse komunitat krijojnë mundësi të barabarta dhe mbështetje të drejtpërdrejtë për gratë që punojnë në këto sektorë.

Në përfundim, raporti tregon për përparime të bëra në komunitat, si Podujevë dhe Shtime, veçanërisht në përfshirjen e grave në buxhetim dhe mundësitë që ato kanë për të përfituar nga subvencionet dhe shërbimet e ofruara. Megjithatë, shumë gra mbeten të përjashtuara nga mundësitë për t'u angazhuar dhe përfituar në mënyrë të barabartë, veçanërisht në sektorët e bujqësisë dhe biznesit. Për të siguruar një zhvillim të barabartë dhe të drejtë, është e nevojshme që të merren masa të mtejshme për të balancuar shpërndarjen e fondeve dhe për të siguruar që gratë të kenë qasje të barabartë në mundësitë financiare dhe zhvillimore.

Metodologjia:

Ky kapitull përshkruan qasjen e përdorur për analizën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ) në tri komuna: Podujevë, Dragash dhe Shtime. Fokusi kryesor është identifikimi i dallimeve dhe ngjashmërive në implementimin e politikave të BPGJ në këto komuna, si dhe ndikimi i tyre në barazinë gjinore dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Analiza e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor është shtrirë në tri komuna: Podujevë, Dragash dhe Shtime, që përfaqësojnë një dallueshmëri të gjerë të karakteristikave demografike, sociale dhe territoriale. Secila komunë ka veçoritë e saj specifike që ndikojnë në mënyrën se si buxheti i përgjegjshëm gjinor implementohet dhe në ndihmesën që ai ofron për barazinë gjinore dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Megjithatë, janë nxjerrë elementet që kanë ngjashmëri dhe janë vendosur në krahasim mes komunave.

- **Komuna e Podujevës:** Podujeva është në mesin e Komunave të mëdha, me një territor të gjerë dhe një popullsi të konsiderueshme. Kjo komunë ka një strukturë të diversifikuar, me sfida të veçanta në lidhje me mbulimin e nevojave të të gjithë qytetarëve të saj, përfshirë gratë dhe grupe të tjera të marginalizuara. Kjo e bën Podujevën një shembull të rëndësishëm për analizimin e implementimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) në komunat me territor të madh dhe popullsi të lartë.
- **Komuna e Dragashit:** Dragashi është një komunë që karakterizohet nga një diversitet etnik i pasur, ku jetojnë grupe të ndryshme etnike, përfshirë shqiptarët dhe goranët boshnjakët, si dhe pakica të tjera. Ky diversitet ka ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si komunat e tilla e ndërtojnë dhe implementojnë politikat për barazi gjinore dhe mbështetje për të gjitha grupet etnike, duke përfshirë gratë. Dragashi gjithashtu ka një territor të gjerë dhe ndodhet në një pozicion që përfshin zona të thella rurale, që kërkojnë një qasje të veçantë për buxhetimin dhe përfshirjen gjinore.
- **Komuna e Shtimes:** Shtimja, e vendosur në qendër të Kosovës, është një komunë që konsiderohet e mesme për nga popullsia dhe territori. Edhe pse më e vogël se Podujeva dhe Dragashi, ajo ka rëndësi të madhe për analizën e implementimit të BPGJ në një kontekst komunal me sfida të veçanta për të siguruar mbështetje për gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara.

Analiza është zhvilluar mes periudhës Korrik – Nëntor 2024 dhe janë përdorur katër qasje kryesore:

- i. **Përgatitja e takimeve dhe dëgjimeve për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ):** Kjo ka përfshirë organizimin dhe zhvillimin e takimeve dhe dëgjimeve buxhetore që përfshijnë të gjithë aktorët relevantë, duke përfshirë përfaqësues të organizatave joqeveritare, sektorit privat dhe sektorit publik, si dhe qytetarë të përfshirë. Gjatë këtyre takimeve është dhënë mundësia për diskutime mbi nevojën për integrimin e perspektivës gjinore në proceset e buxhetimit dhe përgatitjen e buxhetit të vitit të ardhshëm.
- ii. **Shpjegimi i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) si koncept në hartimin e Buxheteve Komunale:** Një nga qëllimet e këtij hulumtimi ka qenë sqarimi i konceptit të

BPGJ dhe rëndësisë së tij në hartimin dhe ekzekutimin e buxheteve komunale. Ky koncept ka të bëjë me përfshirjen e perspektivës gjinore në çdo fazë të procesit buxhetor, duke siguruar që të drejtat dhe nevojat e grave të adresohen në mënyrë të barabartë gjatë shpërndarjes së burimeve publike. Shpjegimi i këtij koncepti është bërë për të siguruar një kuptim të përbashkët mbi rëndësinë e integritit të barazisë gjinore në politikat dhe buxhetin e komunave.

- iii. **Analiza e ndikimit të BPGJ në Shtojcat e Buxhetit:** Analiza është zgjeruar për të vlerësuar se si BPGJ ka ndikuar në shtojcat e buxhetit në komunat përkatëse për vitet 2023-2025. Kjo përfshin vlerësimin e implementimit të BPGJ në ndarjen e fondeve për projekte dhe shërbime që janë të rëndësishme për gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara, përfshirë shërbime shëndetësore, arsimore dhe sociale. Kjo qasje ka për qëllim të vlerësojë se deri në çfarë niveli buxheti është krijuar me një perspektivë të barabartë gjinore dhe sa janë alokuar burimet për t'u siguruar që gratë të kenë mundësi të barabarta për të përfituar.
- iv. **Niveli i adresimit të kërkesave nga gratë në Dëgjimet Buxhetore:** Kjo qasje ka vlerësuar se sa janë adresuar kërkesat specifike të grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara gjatë dëgjimeve buxhetore për projektbuxhetin e vitit 2025. Në këtë pjesë të analizës është pasqyruar sesi kërkesat që kanë ardhur nga gratë janë trajtuar, sa janë pranuar, dhe në çfarë mase janë integruar në buxhetet e vitit pasues. Ky proces ka ndihmuar në identifikimin e boshllëqeve në mundësitë e grave për të kontribuar në proceset e buxhetimit dhe të përfitojnë nga burimet që janë alokuar.

Analiza e Gjendjes

Ky kapitull analizon kuadrin ligjor dhe strategjitë që mbështesin buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në nivel kombëtar dhe komunal. Ai përfshin një përmbledhje të Ligjit për Barazi Gjinore, Programit Nacional për Barazi Gjinore (2020-2024), dhe Qarkores Buxhetore 2025/01, duke treguar detyrimet institucionale për të integruar perspektivën gjinore në menaxhimin e financave publike.

Baza Ligjore dhe Strategjitë

Referuar **Ligjit për Barazi Gjinore**¹, neni 3, përkufizimet, 1.17. Buxhetimi gjinor - është zbatimi i integritimit gjinor në procesin buxhetor. Kjo do të thotë vlerësim i buxheteve nga pikëpamja e gjinisë, në rastin kur çështja gjinore është marrë parasysh në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, të hyrave dhe shpenzimeve të ristrukturimit me qëllim të promovimit të barazisë së femrave dhe meshkujve;

Ne këtë frymë edhe **Programi² Nacional për Barazi Gjinore (2020-2024)**³ përcakton objektiva dhe veprime për komunat sikurse: Objektivi strategjik 1.2 Sigurimi/avancimi i qasjes së barabartë në të drejta, liri, vendimmarrje, burime dhe shërbime, veprimi 2.14 'Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e BPGj, në nivel qendror dhe lokal'; Qëllimi specifik 2.2 Krijimi i mjedisit të favorshëm për realizimin e të drejtave, kapaciteteve dhe potencialeve njerëzore; Veprimi 2.5 'Analiza të buxhetit me perspektivë gjinore në fushën e arsimit, shkencës, sportit, energjetikes, kulturës, rinisë, diasporës, shëndetësisë, kthimit dhe komuniteteve'.

Referuar **Qarkores Buxhetore 2025/01**⁴, indikatorët e performances, organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe komunal duhet të prezantojnë indikatorët e performancës të përmbledhur sipas objektivave dhe aktiviteteve përkatëse në nivel të organizatës buxhetore, bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Organizatat buxhetore duhet të paraqesin 1 deri në 5 objektiva, të cilat janë të lidhura me strategjitë dhe mbulojnë programet më të rëndësishme, duke përfshirë paraqitjen e objektivave dhe aktiviteteve për barazi gjinore aty ku vlerësohet relevante. Treguesit e matjes së aktiviteteve duhet të prezantohen në mënyrë konkrete dhe të qartë për çdo aktivitet.

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ), duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 (2015)⁵, institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për "përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve" (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2024. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe

¹Gazeta Zyrtare. (2015). Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Kuvendi i Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11185>

² Deri në hartimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, 2025-2035

³ Agjencia për Barazi Gjinore. (2020). Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024. Agjencia për Barazi Gjinore. <https://abgi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGI%20Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Barazi%20Gjinore%202020-2024.pdf>

⁴ Ministria e Financave. (2024). Qarkorja buxhetore 2025 [Word document]. Retrieved from <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fvushtrri.rks-gov.net%2Fwp-content%2Fuploads%2F2024%2F05%2FQarkorja-Buxhetore-2025-01-Ministria-e-Financave.docx&wdOrigin=BROWSELINK>

⁵ Gazeta Zyrtare. (2015). Ligji nr. 05/L-020 për barazi gjinore. Kuvendi i Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

transparencës së menaxhimit të financave publike. Komunitet duhet të marrin parasysh këto udhëzime në nxjerrjen e qarkores së brendshme buxhetore komunale, si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2025-2027. Organizatat buxhetore gjithashtu duhet të publikojnë këto të dhëna. Kërkesa për buxhet nga organizata buxhetore të nivelit qendror dhe Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP) duhet të përfshijë: Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjimore.

Raportet dhe evidencat

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023⁶ thekson disa përparime dhe sfida kryesore në fushat e qeverisjes, barazisë gjimore, të drejtave themelore dhe politikave sociale. Përfaqësimi i grave në pozitë e larta qeveritare është rritur, por mbetet ende i pabarabartë, sidomos në nivelin lokal, ku gratë janë të nën-përfaqësuara në organet vendimmarrëse. Ndërhijet afirmative janë të nevojshme për të siguruar përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në pushtetin vendor. Në shërbimin civil, gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara në pozitë e larta, dhe nevojiten masa për rritjen e përfaqësimit të tyre, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjimore.

Sa i përket të drejtave themelore, Kosova ka miratuar Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjimore⁷, një hap pozitiv, por mbetet sfida e zbatimit efektiv të këtyre të drejtave. Kapaciteti i qeverisë për të përmirësuar mbikëqyrjen e të drejtave themelore, veçanërisht në nivel lokal, kërkon përmirësime. Një aspekt pozitiv është rritja e pronësisë së grave mbi pronat, me regjistrimin e 6951 pronave në emër të grave në vitin 2022, një rritje e dukshme krahasuar me vitin 2021, por vetëm 19.2% e pronave janë regjistruar në emër të të dy bashkëshortëve, gjë që tregon se nevojiten përpjekje të mëtejshme për barazi në pronësi⁸.

Në aspektin e politikave sociale dhe punësimit, raporti thekson se gratë vazhdojnë të përballen me diskriminim në proceset e punësimit, avancimit dhe pagesës. Hendeku gjimor në punësim është i lartë, me 18.4% për gratë dhe 49.4% për burrat, duke krijuar një diferencë prej 31 pikë përqindjeje. Mungesa e kujdesit për fëmijët dhe fleksibilitetit në punë mbeten pengesa kryesore për gratë, veçanërisht në zonat rurale⁹. Për më tepër, ndarja e pabarabartë e pushimit të lehonisë dhe prindëror midis grave dhe burrave e përkeqëson këtë situatë, duke dekurajuar pjesëmarrjen e grave në tregun e punës¹⁰. Trajnimet për inspektorët e punës dhe gjyqtarët për adresimin e diskriminimit gjimor janë të domosdoshme për të ndihmuar në tejkalimin e këtyre pengesave.

Referuar Raportit të Performances Komunale (2023)¹¹, në fushën e përfaqësimit gjimor, barazia gjimore tek përbërja e këshillave lokal del, 6%, barazia gjimore tek anëtarët e komiteteve komunale

⁶ Komisioni Evropian. (2023). Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023. Komisioni Evropian. https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/documents/2023/Kosovo%202023%20Report_SQ.PDF

⁷ Po aty, fq.30

⁸ Po aty, fq. 36-37

⁹ Po aty, fq. 108

¹⁰ Po aty, fq.108

¹¹ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. (2024). Raporti i Performancës Komunale 2023. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. <Raporti-performances-Komunale-2023-final-18.07.2024.pdf>

del, 91.18%, gratë e emëruar ne pozita politike del, 39.13%, gratë ne pozita udhëheqëse komunale del, 47.23%, gratë e punësuar në institucione/administratë komunale del 78.20%. Përderisa, tek barazia gjinore në përfitimet e programeve dhe aktivitete te komunës, tek plani komunal për barazi gjinore 47.06%, tek pjesëmarrja në konsultime publike, del 54.73%, barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave del, 28.76% dhe buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor del, 69.12%. Përderisa tek master tabela e performances komunale (2023)¹², në tri komuna del se arritja e pjesëmarrja e grave në konsultime publike është vlerësuar: Podujeve, 16.24%; Shtime, 35.55% dhe Dragash nuk ka marre asnjë pikë.

Referuar Raportit të përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar – Qershor 2024¹³ del se: sa i përket zyrtarit për barazi gjinore është caktuar në 25 komuna, ndërsa në 4 komuna nuk është emëruar zyrtari përkatës; Në kuadër të agjendës evropiane, mbështetja për gratë në udhëheqjen e bizneseve është një aktivitet me rëndësi. Gjatë periudhës raportuese, në 25 komuna të Kosovës janë identifikuar 3,670 biznese të udhëhequra nga gra, ndërsa në Skenderaj nuk ka biznese të udhëhequra nga gra, dhe në dy komuna (Viti dhe Prishtinë) nuk janë ofruar të dhëna. Nga 16 komuna (p.sh., Glllogoc, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj), është ndarë një buxhet prej 1,095,500 euro për subvencionimin e bizneseve. Ndërkohë, 13 komuna të tjera (p.sh., Mitrovicë Veriore, Lipjan, Prizren) nuk kanë ndarë buxhet për këtë qëllim; Komunitat në Kosovë kanë bërë përpjekje për të promovuar barazinë gjinore dhe të drejtat pronësore të grave. Në 29 komuna janë 1,107 gra në pozita menaxheriale dhe në 27 komuna janë 100 drejtoresha, ndërsa dy komuna nuk kanë drejtoresha. Për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat pronësore të grave, 22 komuna kanë organizuar aktivitete si fushata informuese, tryeza dhe trajnime për regjistrimin e pronës së përbashkët. Në periudhën janar-qershor 2024, në 24 komuna janë regjistruar 4,944 prona në emër të dy bashkëshortëve. Në shtatë komuna nuk ka pasur asnjë aktivitet për të drejtat pronësore të grave, dhe katër komuna nuk kanë regjistruar prona në emër të dy bashkëshortëve.

Vlerësimi i kapaciteteve të strukturave komunale për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore¹⁴ në 24 komuna të Kosovës tregon mungesa të konsiderueshme në përfaqësim dhe financim. Peja dhe Shtërpca nuk kanë njësi të dedikuara për të drejtat e njeriut apo zyrtarë për barazinë gjinore, ndërsa shumica e komunave të tjera raportojnë njësi ose zyra për këto çështje. Për vitin 2020, nga buxheti total prej 169,072 euro i ndarë për çështjet gjinore në 11 komuna, vetëm 11% (18,700 euro) ishte dedikuar për subvencione dhe transfere, pa ndarje për investime kapitale. 89% e këtij buxheti u përdor për paga, shtesa dhe mallra e shërbime, duke lënë pak hapësirë për mbështetje direkte për grupet e marginalizuara. Në vitin 2021, përqindja e subvencioneve dhe transfereve u rrit në 14.5% (25,500 euro), duke reflektuar një rritje prej 27% krahasuar me vitin e mëparshëm. Megjithatë, asnjë fond nuk u alokua për shpenzime kapitale, dhe 85.5% e buxhetit vijonte të shpenzohej për paga dhe mallra. Në vitin 2022, buxheti për subvencione dhe transfere mbeti i pandryshuar në vlerën prej 25,500 euro, por përqindja totale për këtë kategori u ul lehtësisht për

¹² Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. (2024). [Databaza GP 2024-per-performanc-2022_additional-funds_Final_2202.xlsx](#)

¹³ [Raporti-i-permbushjes-se-obligimeve-te-komunave-nga-Agjenda-Evropiane-Janar-Dhjetor-2023.pdf](#)

¹⁴ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. (2023). *Vlerësimi i kapaciteteve të strukturave komunale për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore*. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fmapl.rks-gov.net%2Fwp-content%2Fuploads%2F2023%2F09%2FRaporti_GSE-final-00000003.docx&wdOrigin=BROWSELINK

shkak të një rënieje të përgjithshme prej 3.5% në buxhetin total të 11 komunave. Kjo nënvizon kufizimet e komunave në ofrimin e përkrahjes së qëndrueshme për grupet e marginalizuara, pasi mungesa e investimeve kapitale dhe përqendrimi në shpenzime administrative vështirëson zbatimin e projekteve të vazhdueshme dhe të strukturuar.

Ndërkaq, referuar Raportit për Vlerësimin e Transparencës (janar – dhjetor) 2023¹⁵, del se Lista e investimeve kapitale është një dokument financiar dhe përcakton shpenzimet kapitale që rezultojnë të nevojshme për zbatimin e vendimeve, të planeve të caktuara në komuna. Lista e investimeve kapitale përcakton kohën e realizimit, koston, burimet e financimit si dhe informacione të tjera të detajuara. Publikimi i Listës së shpenzimeve kapitale është pjesë e transparencës financiare dhe përcakton prioritetin më të lartë të sigurimit të fondeve, si dhe ndarjes buxhetore të nevojshme për financimin e rregullt të projektit kapital gjatë përgatitjes dhe miratimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

¹⁵ **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. (2024).** *Raporti për vlerësimin e transparencës (janar – dhjetor) 2023.* Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fmapl.rks-gov.net%2Fwp-content%2Fuploads%2F2024%2F05%2FnRAPORTI..-PER-VLERESIMIN-E-TRANS-11-04-2024-.docx&wdOrigin=BROWSELINK>

Vlerësimi i Proceseve Buxhetore

Ky kapitull analizon procesin e dëgjimeve buxhetore në komunat e Dragashit, Shtimes dhe Podujevës, duke vlerësuar përfshirjen e grave dhe vajzave në këto procese. Gjithashtu, përfshin një analizë të qasjes ndaj Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ) dhe përfaqësimin e grave në vendimmarrje komunale.

Në periudhën e zhvillimit të dëgjimeve buxhetore në komunat e Dragashit, Shtimes dhe Podujevës, u evidentuan qasje të ndryshme në përfshirjen e grave dhe vajzave në këto procese. Komunat e Dragashit¹⁶ dhe Shtimes¹⁷ organizuan diskutime të fokusuara me gratë dhe vajzat, ndërsa Komuna e Podujevës¹⁸ fillimisht nuk kishte planifikuar dëgjime të dedikuara, por pas angazhimit të projektit, kalendarët u adaptuan dhe u mbajtën dëgjime të veçanta në të tria komunat.

Pavarësisht këtij përmirësimi, asnjë komunë nuk kishte hartuar plane të veçanta të shtrirjes (outreach plans) për të siguruar pjesëmarrjen e grave dhe vajzave. Mungesa e këtyre planeve ndikoi negativisht në mobilizimin e burimeve dhe në marrjen parasysh të faktorëve pengues, si oraret e takimeve, transporti apo nevoja të tjera që kufizojnë pjesëmarrjen e grave.

Në lidhje me Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ), u vërejt një qasje e pjesshme. Për vitin 2025 dhe projeksionet për vitet 2026 dhe 2027, shtojca e BPGJ u bashkëngjit vetëm nga Komuna e Podujevës¹⁹. Ndërkohë, Komuna e Shtimes²⁰ kishte të publikuar shtojcën për vitin 2024 dhe Komuna e Dragashit për vitin 2023²¹. Ky hendek në planifikimin gjinator tregon për një mungesë konsistence në integrimin e perspektivës gjinore në dokumentet buxhetore.

Referuar Raporteve dhe Procesverbaleve nga Dëgjimet Buxhetore në Komunat: Podujevë²², Shtime²³ dhe Dragash²⁴. Dëgjimet nxorën në pah se kërkesat e grave reflektonin sfida të shumanshme dhe gjithëpërfshirëse, që shkonin përtej buxheteve të pagave dhe subvencioneve. Këto kërkesa përfshinin nevoja si transporti, kujdesi ndaj fëmijëve, siguria publike, shërbimet sociale dhe shëndetësore, si dhe investime në hapësira publike e kulturore.

Në një analizë më të gjerë, u konstatua se komunat nuk kanë zhvilluar ende politika dhe strategji të qarta për fuqizimin ekonomik të grave. Ky boshllëk është reflektuar edhe në Kornizat

¹⁶ Komuna e Dragashit. (2024). *Kalendari i dëgjimeve*. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Kalendari-i-degjimeve-shqip.pdf>

¹⁷ Komuna e Shtimes. (2024). *Postim në faqen zyrtare, kalendari i dëgjimeve buxhetore* [Postim në Facebook]. Facebook. https://www.facebook.com/photo.php?fbid=838261581763362&id=100067385829724&set=a.261309532791906&locale=ro_RO

¹⁸ Komuna e Podujevës. (2024). *Kalendari i dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për buxhetin e vitit 2025*. Komuna e Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/08/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-publike-me-qytetare-per-buxhetin-e-vitit-2025.pdf>

¹⁹ Komuna e Podujevës. (2024). *Buxheti 2025-2027 i miratuar në Kuvend*. Komuna e Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/10/Buxheti-2025-27-i-miratuar-ne-Kuvend.pdf>

²⁰ Komuna e Shtimes. (2024). *Buxheti i përgjithshëm gjinator*. Komuna e Shtimes. <https://kk.rks-gov.net/shtime/wp-content/uploads/sites/28/2023/06/Buxheti-i-pergjithshem-gjinator-1.pdf>

²¹ Komuna e Dragashit. (2023). *Buxheti gjinator 2023*. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Buxheti-Gjinator-2023.pdf>

²² Komuna e Podujevës. (2025). *Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt-buxhetin e komunës për vitin 2025*.

²³ Komuna e Shtimes. (2025). *Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar: gra, të rinj, pensionistë, persona me aftësi të kufizuara*.


²⁴ Komuna e Dragashit. (2025). *Raporti i dëgjimeve 2025*. Komuna e Dragashit. <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/10/Raporti-i-degjimeve-2025-PDF.pdf>

Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe në buxhetet vjetore²⁵, ku mungon integrimi i perspektivës gjinore. Nevojitet që fuqizimi ekonomik i grave të përfshihet më thellësisht në programet politike dhe të reflektohet qartë në Planet Zhvillimore dhe Strategjitë Komunale.

Një tjetër sfidë e rëndësishme është angazhimi i kufizuar i grave përfaqësuese në Kuvendet Komunale²⁶. Ky kufizim dëmton jo vetëm informimin dhe përfshirjen e grave, por edhe adresimin efektiv të kërkesave të tyre. Po ashtu, mungon një program i qartë dhe i qëndrueshëm për të nxitur pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje.

Përfaqësimi i grave pozitave udhëheqëse politike

Bazuar në të dhënat nga ueb faqet komunale, del se përfaqësimi i grave në pozita politike, në



komunat Podujevë, Shtime dhe Dragash, del të jetë: Podujevë, përfaqësimi në pozita politike është 6 gra, përfshirë (nënkryetaren dhe pesë drejtori²⁷); 6 gra nga 14 pozita politike apo 42.85%. Në komunën e Shtimes, përfaqësimi në pozita politike del të jetë 4 gra (Arsimit; Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Prokurimit Publik dhe Inovacionit dhe Zhvillimit të Projekteve). 4 gra

nga 14 pozita politike, apo 28.57%. Përderisa në Komunën e Dragashit përfaqësimi në pozita politike del të jetë 2 gra (Kryesuesja e Kuvendit Komunal dhe Drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit). 2 gra nga 10 pozita politike, apo 20%.

Komuna	Numri i Grave	Numri i Pozitave Politike	Përqindja e Grave (%)
Podujevë	6 gra	14 pozita	42.85%
Shtime	4 gra	14 pozita	28.57%
Dragash	2 gra	10 pozita	20%

Pasqyrimi i përbërjes së Kuvendeve Komunale

Përderisa, sipas të dhënave nga përbërja e Kuvendeve Komunale del se: Në Komunën e Podujevës, nga 35 anëtar të Kuvendit Komunal, 12 janë gra, apo 34.29%; në Komunën e Shtimes,

²⁵ Komuna e Podujevës. (2024). Buxheti 2025-2027 i miratuar në Kuvend. Komuna e Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/10/Buxheti-2025-27-i-miratuar-ne-Kuvend.pdf>; Komuna e Shtimes. (2024). Buxheti i përgjithshëm gjinor. Komuna e Shtimes. <https://kk.rks-gov.net/shtime/wp-content/uploads/sites/28/2023/06/Buxheti-i-pergjithshem-gjinor-1.pdf>; Komuna e Dragashit. (2023). Buxheti gjinor 2023. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Buxheti-Gjinor-2023.pdf>

²⁶ Demokracia për Zhvillim (D4D). (2022). Përtej barazisë numerike: Fuqizimi i grave anëtare të kuvendeve të komunave në qeverisje lokale. Demokracia për Zhvillim. <https://d4d-ks.org/punimet/pertej-barazise-numerike-fuqizimi-grave-anetare-te-kuvendeve-te-komunave-ne-qeverisje-lokale/>

²⁷ Ueb Faqja (2024) Komuna e Podujevës. Nënkyetarija; Drejtoritë: Administratës; Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë; Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

nga 21 anëtar, 7 janë gra, apo 33.33% dhe në Komunën e Dragashit, nga 27 anëtar, 10 janë gra, apo 37.04%. Bazuar në të dhënat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Lokale 2021, përfaqësimin në Kuvendin Komunal, në Podujevë, nga 12 gra, 5 prej tyre apo 41.7% kanë marrë mandatin bazuar në kuotën gjinore 30% dhe 7 prej tyre kanë kaluar në garë me vota apo 57.3%. Në Kuvendin Komunal të Shtimes, nga 7 gra anëtare, 2 prej tyre apo 28.6% kanë marrë mandatin bazuar në kuotën gjinore 30% dhe 5 prej tyre kanë kaluar në garë me vota apo 71.4%. Përderisa në Komunën e Dragashit, nga 10 gra anëtare, 2 prej tyre apo 20% kanë marrë mandatin bazuar në kuotën gjinore 30% dhe 8 prej tyre kanë kaluar në garë me vota apo 80%.²⁸

Komuna	Anëtarët e Kuvendit Komunal	Gra në Kuvend (numri dhe %)	Gra nga Kuota Gjinore (numri dhe %)	Gra nga Votat (numri dhe %)
Podujevë	35	12 (34.29%)	5 (41.7%)	7 (57.3%)
Shtime	21	7 (33.33%)	2 (28.6%)	5 (71.4%)
Dragash	27	10 (37.04%)	2 (20%)	8 (80%)

Punësimi, Pagat dhe Subvencionet në Komunën e Podujevës

Punësimi dhe Barazia Gjinore në Paga

Nga vitet 2022 deri në planin për 2025²⁹, numri i përgjithshëm i stafit në organizatat buxhetore të Komunës së Podujevës është rritur nga **1,992** në **2,045**. Megjithatë, rritja e përfaqësimit të grave mbetet modeste, me vetëm **123 gra** më shumë të punësuara në katër vite. Ndërsa burrat dominojnë ende në numër, diferenca midis burrave dhe grave të punësuara është ngushtuar, por pa arritur barazi të plotë.

Në aspektin e pagave:

- Fondi për pagat e grave është rritur nga **5,096,907 €** në **8,830,530 €**;
- Në vitin 2025, paga mesatare për gratë është **8,717 €**, ndërsa për burrat **8,685 €**.

Tabela 1: Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore të Komunës së Podujevës

Viti	Numri Total i stafit	Numri i stafit që janë Gra	Numri i stafit që janë Burra	Paga dhe mëditje (shuma për gra) (€)	Paga dhe mëditje (shuma për burra) (€)
2022	1,992	890	1,102	5,096,907.28	6,859,976.64
2023	2,013	901	1,112	5,171,487.28	6,934,556.64
2024	2,022	1,000	1,022	8,093,882.00	8,193,882.00
2025	2,045	1,013	1,032	8,830,530.00	8,962,530.00

Struktura e pagave sipas niveleve (2025)

²⁸ Kosovo Local Government Institute. (2022). *Hulumtimi: Pasqyrimi i përbërjes së Kuvendeve Komunale*. Kosovo Local Government Institute. <https://www.klgi-ks.com/wp-content/uploads/2022/12/Hulumtimi-Pasqyrimi-i-perberjes-se-Kuvendeve-Komunale.pdf>

²⁹ Komuna e Podujevës. (2024). *Buxheti 2025-2027 i miratuar në Kuvend*. Komuna e Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/10/Buxheti-2025-27-i-miratuar-ne-Kuvend.pdf>

Analiza e niveleve të pagave tregon se gratë janë të përqendruara kryesisht në nivelet e ulëta dhe të mesme të pagave:

- **Niveli 201-400 €:** Gratë përbëjnë vetëm **21%** të stafit, me një shpërndarje të pabarabartë të fondit për paga (**935,354 €** për gratë kundrejt **1,473,322 €** për burrat).
- **Niveli 400-600 €:** Pavarësisht një shpërndarjeje më të barabartë të stafit (**801 gra dhe 842 burra**), burrat marrin një pjesë më të madhe të fondit (**6,488,433 €** kundrejt **5,912,631 €** për gratë).
- **Niveli mbi 600 €:** Gratë përfaqësojnë vetëm **43%** të stafit në këtë kategori, duke reflektuar ende mungesën e tyre në pozitat më të larta;

Tabela 2: Planifikimi për vitin 2025 - nivelet e pagave në Organizatat Buxhetore

Niveli i pagave (€)	Numri Total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra (€)	Numri i grave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për gra (€)
201-400	293	230	1,473,322.80	62	935,354.04
400-600	1,643	842	6,488,433.38	801	5,912,631.22
600+	109	62	857,816.28	47	597,906.32

Subvencionet dhe përfitimet sipas gjinive (2022-2025)

Në aspektin e subvencioneve, është vërejtur një përmirësim i lehtë në përfshirjen e grave, por ende ekziston një pabarazi në shpërndarjen e fondeve:

- **Numri i grave përfituese** është rritur nga **463** në **830**, por përqindja e tyre ka mbetur nën **50%**, duke arritur vetëm **48.8%** në vitin 2025.
- **Buxheti për gratë** është rritur nga **173,954 €** në **850,000 €**, por burrat vazhdojnë të marrin pjesën më të madhe të fondeve (**960,000 €**).
- Kjo pabarazi sugjeron se kriteret për përfitim janë më të favorshme për burrat, sidomos në sektorë si bujqësia dhe ndërmarrjet.

Tabela 3: Numri i përfituesve të subvencioneve apo shërbimeve të ofruara nga organizatat buxhetore

Viti	Buxheti total i subvencionit të caktuar (€)	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve Gra	Numri i përfituesve Burra	Buxheti për Gra (€)	Buxheti për Burra (€)
2022	860,050	1,114	463	651	173,954.04	307,014.00
2023	1,600,050	1,500	700	800	600,000.00	800,000.00
2024	1,670,000	1,655	775	875	780,000.00	890,000.00
2025	1,810,000	1,700	830	870	850,000.00	960,000.00

Punësimi, Pagat dhe Subvencionet në Komunën e Shtimes

Punësimi dhe barazia gjinore në paga

Nga viti 2021 deri në planifikimin për vitin 2024³⁰, numri total i stafit në Komunën e Shtimes është rritur nga 665 në 711. Gjatë kësaj periudhe, numri i grave të punësuar është rritur nga 329 në 365, duke përfaqësuar 51.3% të stafit në vitin 2024, një shembull pozitiv i përfaqësimit gjinor.

Në aspektin e pagave:

- **Paga totale për gratë** është rritur ndjeshëm nga **2,124,905 €** në **2,876,935 €** (2024), ndërsa pagat për burrat janë rritur më ngadalë nga **2,235,998 €** në **2,727,176 €**.
- **Paga mesatare vjetore për gratë** në vitin 2024 është **7,880 €**, ndërsa për burrat është **7,880 €**, duke treguar një barazi të plotë në pagat mesatare, që është një shembull i rrallë pozitiv midis komunave.

Tabela 1: Numri i punëtorëve në Komunën e Shtimes

Viti	Numri total i stafit	Numri i stafit që janë gra	Numri i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje (shuma për Gra) (€)	Paga dhe mëditje (shuma për Burra) (€)
2021	665	329	337	2,124,905.38	2,235,998.62
2022	665	339	326	2,458,541.64	1,947,043.36
2023	711	365	346	2,345,584.35	2,253,600.65
2024*	711	365	346	2,876,934.62	2,727,176.38

Struktura e Pagave sipas Niveleve (2024)

Edhe pse barazia gjinore është e dukshme në pagat mesatare, një analizë më e thellë tregon përqendrimin e grave në nivelet e mesme të pagave dhe përqendrimin e burrave në nivelet më të larta të pagave:

- **Niveli 201-400 €:** Gratë përbëjnë **45.4%** të stafit (54 nga 119), por marrin një fond më të vogël pagash se burrat (**425,628 €** kundrejt **512,330 €**).
- **Niveli 401-600 €:** Në këtë nivel, gratë janë shumicë (**54.2%**), por fondi i pagave është më i lartë për to (**2,199,081 €** për gratë kundrejt **1,860,154 €** për burrat). Ky është sektori ku gratë dominojnë dhe kontribuojnë në barazinë e pagave totale.
- **Niveli mbi 600 €:** Burrat përfaqësojnë **58.4%** të stafit dhe marrin pjesën më të madhe të fondit të pagave (**354,690 €** për burra kundrejt **252,224 €** për gra), duke treguar pabarazi në qasjen ndaj pozicioneve më të larta.

Tabela 2: Planifikimi për vitin 2024 - Niveli i pagave në Komunën e Shtimes

Nivelet e pagave (€)	Numri total i stafit në nivele të pagave	Numri i burrave	Shuma e shpenzuar për burra (€)	Numri i Grave	Shuma e shpenzuar për gra (€)
----------------------	--	-----------------	---------------------------------	---------------	-------------------------------

³⁰ Komuna e Shtimes. (2024). Buxheti i përgjithshëm gjinor. Komuna e Shtimes. <https://kk.rks-gov.net/shtime/wp-content/uploads/sites/28/2023/06/Buxheti-i-pergjithshem-gjinor-1.pdf>

201-400	119	65	512,330.82	54	425,628.68
401-600	515	236	1,860,154.99	279	2,199,081.53
600+	77	45	354,690.57	32	252,224.41
Total	711	346	2,727,176.38	365	2,876,935.00

Analiza e Subvencioneve dhe Përfitimeve sipas Gjinive (2022-2024)

Subvencionet e Përgjithshme (2022-2024):

- **Numri i grave përfituese** është rritur nga **60 (2022)** në **200 (2024)**, duke përfaqësuar **66.7%** të përfituesve.
- **Buxheti i dedikuar për gratë** është rritur nga **100,000 €** në **233,333 €**, që është pothuajse dyfishi i buxhetit për burrat (**116,666 €**).
- Ky është një rast pozitiv ku gratë përfitojnë më shumë subvencione si për nga numri ashtu edhe për nga shuma financiare.

Tabela 3: Numri i përfituesve të subvencioneve apo shërbimeve të ofruara nga organizatat buxhetore

Viti	Numri total i shërbimit (subvencionit të caktuar) (€)	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve Gra	Numri i përfituesve Burra	Buxheti për Gra (€)	Buxheti për Burra (€)
2022	150,000	90	60	30	100,000	50,000
2023	300,000	150	105	45	230,000	70,000
2024*	350,000	300	200	100	233,333	116,667

Punësimi, Pagat dhe Subvencionet në Komunën e Dragashit ³¹

Punësimi dhe Pabarazia Gjinore në Paga

Nga viti 2019 deri në vitin 2023, numri i përgjithshëm i stafit ka pësuar luhatje të vogla, duke u rritur nga **722** në **758** punonjës. Edhe pse numri i grave është rritur nga **97** në **130**, përfaqësimi i tyre mbetet i ulët, duke arritur vetëm **17.1%** të totalit në vitin 2023. Ky progres i ngadaltë tregon mungesën e politikave të qarta për promovimin e barazisë gjinore në punësim.

Në aspektin e pagave:

- **Paga totale për gratë** është rritur nga **600,000 €** (2019) në **900,000 €** (2023), ndërsa për burrat nga **3,968,960 €** në **4,324,837 €**.
- **Paga mesatare vjetore për gratë** në 2023 është **6,923 €**, ndërsa për burrat është **6,886 €**. Diferenca e vogël në paga mesatare fsheh faktin që gratë janë të përqendruara në pozita me pagë të ulët dhe janë të nënpërfaqësuar në pozitat më të paguara.

³¹ Komuna e Dragashit. (2023). Buxheti gjinor 2023. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Buxheti-Gjinor-2023.pdf>

Tabela 1: Numri i punëtorëve në Komunën e Dragashit

Viti	Numri total i stafit	Numri i stafit që janë gra	Numri i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje (shuma për gra) (€)	Paga dhe mëditje (shuma për burra) (€)
2019	722	97	625	600,000.00	3,968,960.00
2020	720	100	620	700,000.00	4,565,853.00
2021	718	102	616	750,000.00	4,030,466.00
2022	713	120	593	850,000.00	3,980,821.00
2023	758	130	628	900,000.00	4,324,837.00

Struktura e Pagave sipas Niveleve (2023)³²

Analiza sipas kategorive të pagave tregon një shpërndarje të pabarabartë:

- **Niveli 201-400 €:** Gratë përfaqësojnë vetëm **16.3%** të stafit (30 nga 184), me një fond pagash për gratë (**190,584 €**) tre herë më të vogël se për burrat (**641,413 €**).
- **Niveli 401-600 €:** Edhe pse ka përfaqësim më të mirë të grave (**95 gra nga 520 staf, 18.3%**), fondi i pagave është shumë më i vogël për gratë (**327,816 €**) krahasuar me burrat (**3,253,424 €**).
- **Niveli mbi 600 €:** Gratë janë pothuajse të përjashtuara nga pozitat më të paguara, me vetëm **5 gra kundrejt 49 burrave**, por me pagë mesatare më të lartë (**76,320 € për gratë, 8,775 € më shumë se burrat**), çka tregon se gratë që arrijnë nivelet e larta, paguhet më mirë.

Tabela 2: Planifikimi për vitin 2023 - Niveli i pagave

Nivelet e pagave (€)	Numri total i stafit në nivele të pagave	Numri i burrave	Shuma e shpenzuar për burra (€)	Numri i Grave	Shuma e shpenzuar për gra (€)
201-400	184	130	641,413.00	30	190,584.00
401-600	520	431	3,253,424.00	95	327,816.00
600+	54	49	430,000.00	5	381,600.00

Analiza e Subvencioneve dhe Përfitimeve sipas Gjinitive (2019-2023)

Subvencionet e Përgjithshme (2019-2023)³³:

- **Numri i grave përfituese** ka luhatur nga **40 (2019)** në **59 (2022)** dhe më pas ka rënë në **40 (2023)**, duke treguar një përkeqësim në përfshirjen e grave.
- **Buxheti i dedikuar për gratë** ka pësuar një rënie të madhe nga **90,000 € (2022)** në vetëm **40,000 € (2023)**, ndërkohë që burrat kanë përfituar më shumë fonde në çdo vit.

³² Komuna e Dragashit. (2023). Buxheti gjinor 2023. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Buxheti-Gjinor-2023.pdf>

³³ Po aty

- Përqindja e grave përfituese në 2023 ishte vetëm **33.3%**, duke reflektuar një mungesë barazie në shpërndarjen e fondeve publike.

Numri i përfituesve të subvencioneve apo shërbimeve të ofruara

Viti	Numri total i shërbimit (subvencionit të caktuar) (€)	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve Gra	Numri i përfituesve Burra	Buxheti për Gra (€)	Buxheti për Burra (€)
2019	50,000	109	40	73	30,000	20,000
2020	180,000	109	36	73	60,000	100,000
2021	200,000	109	50	59	90,000	110,000
2022	200,000	109	59	59	90,000	110,000
2023	100,000	120	40	80	40,000	60,000

Subvencionet sipas Sektorëve (2022-2023)³⁴:

Bujqësia:

- Në vitin 2023, gratë përbënin **41.7%** të përfituesve, por morën vetëm **33,400 €** nga buxheti total prej **80,000 €**, ndërsa burrat përfituan **46,600 €**.
- Edhe pse ka një rritje nga viti 2022, pabarazia financiare mbetet e evidente.

Administrata dhe Arsimi:

- Në vitin 2023, **41.7%** e përfituesve ishin gra, por sërish burrat morën një pjesë më të madhe të fondeve (**46,600 €** për burra dhe **33,400 €** për gra).
- Diferenca tregon një tendencë për favorizimin e burrave edhe në sektorët ku gratë janë zakonisht më të pranishme.

Kulturë, Rini dhe Sport:

- Ky është sektori më i ekuilibruar: në vitet 2022 dhe 2023, fondet janë ndarë në mënyrë të barabartë, **35,000 € për gra dhe 35,000 € për burra**, me një ndarje të barabartë të përfituesve (**50 gra dhe 50 burra**).
- Ky sektor shërben si një model për përfshirjen gjinore dhe shpërndarjen e drejtë të fondeve.

Tabela 4: Numri i përfituesve të subvencioneve sipas sektorëve

Bujqësia:

³⁴ Komuna e Dragashit. (2023). Buxheti gjinor 2023. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Buxheti-Gjinor-2023.pdf>

Viti	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve Gra	Numri i përfituesve Burra	Buxheti për Gra (€)	Buxheti për Burra (€)
2022	100	40	60	20,000	50,000
2023	120	50	70	33,400	46,600

Administrata dhe Arsimi:

Viti	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve Gra	Numri i përfituesve Burra	Buxheti për Gra (€)	Buxheti për Burra (€)
2022	100	40	60	20,000	50,000
2023	120	50	70	33,400	46,600


Kulturë, Rini dhe Sport:

Viti	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve Gra	Numri i përfituesve Burra	Buxheti për Gra (€)	Buxheti për Burra (€)
2022	100	50	50	35,000	35,000
2023	100	50	50	35,000	35,000

Krahasimi mes Komunave

Në këtë kapitull krahasohen të dhënat e punësimit, pagave dhe subvencioneve në Podujevë, Shtime dhe Dragash. Analiza tregon tendencat e ndryshme të komunave në politikën e punësimit dhe mbështetjen financiare për grupet e përfituesve, duke identifikuar fushat ku ka përparime dhe sfida në përfshirjen gjinore.

Pasqyrimi në Administratë Publike Referuar shtojcave për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor³⁵,



në Buxhetet e miratuara për vitin 2025, përveç komunës së Podujevës, në atë të Shtimes, të dhënat i referohen vitit 2024, ndërkaq, në Dragashit ato të vitit 2023. Buxheti i përgjegjshëm gjinor në komunat e Podujevës, Dragashit dhe Shtimes reflekton ndryshimet dhe tendencat në politikën e punësimit, shpërndarjen e pagave dhe mbështetjen financiare për grupet e ndryshme të përfituesve. Analiza e të dhënave tregon se në të gjitha komunat ka


pasur një rritje të lehtë të numrit të punëtorëve ndër vite, me Podujevën që paraqet rritjen më të madhe, nga 1992 punëtorë në vitin 2022 në 2045 të planifikuar për vitin 2025. Dragashi ka pasur luhajtje më të vogla, me një rënie nga 722 punonjës në vitin 2019 në 713 në vitin 2022 dhe një rritje të lehtë në 758 në vitin 2023. Shtimja ka shënuar një rritje më të qëndrueshme, nga 665 në vitin 2021 në 711 në vitin 2023-2024. Tendenda në punësimin e grave është pozitive në të gjitha komunat, megjithatë, pabarazia gjinore mbetet e pranishme. Në Podujevë, numri i grave të punësuar është rritur nga 890 në vitin 2022 në 1013 të planifikuara për vitin 2025, por ato përfaqësojnë ende një përqindje më të vogël të fuqisë punëtore në krahasim me burrat.³⁶ Në Dragash³⁷, pjesëmarrja e grave është rritur nga 97 në vitin 2019 në 130 në vitin 2023, ndërsa në Shtime³⁸, numri i grave është rritur nga 329 në vitin 2021 në 365 në vitin 2023-2024. Kjo tregon një tendencë të përgjithshme për rritjen e përfaqësimit të grave në tregun e punës, por me ritme të ndryshme në varësi të komunës dhe politikave të zbatimit.

³⁵ Komuna e Podujevës. (2024). *Buxheti 2025-2027 i miratuar në Kuvend*. Komuna e Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/10/Buxheti-2025-27-i-miratuar-ne-Kuvend.pdf>; Komuna e Shtimes. (2024). *Buxheti i përgjithshëm gjinor*. Komuna e Shtimes. <https://kk.rks-gov.net/shtime/wp-content/uploads/sites/28/2023/06/Buxheti-i-pergjithshem-gjinor-1.pdf>; Komuna e Dragashit. (2023). *Buxheti gjinor 2023*. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Buxheti-Gjinor-2023.pdf>

³⁶ Komuna e Podujevës. (2024). *Buxheti 2025-2027 i miratuar në Kuvend*. Komuna e Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/10/Buxheti-2025-27-i-miratuar-ne-Kuvend.pdf>

³⁷ Dragashit. (2023). *Buxheti gjinor 2023*. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Buxheti-Gjinor-2023.pdf>


³⁸ Komuna e Shtimes. (2024). *Buxheti i përgjithshëm gjinor*. Komuna e Shtimes. <https://kk.rks-gov.net/shtime/wp-content/uploads/sites/28/2023/06/Buxheti-i-pergjithshem-gjinor-1.pdf>



Paga dhe mëditjet tre gojnë një pabarazi të dukshme gjinore. Në Podujevë³⁹, shpenzimet për paga për burrat kanë qenë vazhdimisht më të larta, me 6.8 milionë euro në vitin 2022 kundrejt 5.1 milionë euro për gratë, ndërsa në vitin 2025, diferenca mbetet e konsiderueshme me 8.9 milionë euro për burrat dhe 8.8 milionë euro për gratë. Dragashi⁴⁰ gjithashtu shfaq një

diferencë të theksuar, ku gratë në vitin 2023 kanë përfituar 900 mijë euro ndërsa burrat 4.3 milionë euro. Në Shtime⁴¹, ndarja gjinore e pagave është më e ekuilibruar, me 2.8 milionë euro për gratë dhe 2.7 milionë euro për burrat në vitin 2024. Këto të dhëna tregojnë se ndërsa numri i grave në punësim po rritet, diferenca në paga mbetet problematike dhe kërkon ndërhyrje të mëtejshme për të siguruar barazi të plotë.

Struktura e pagave sipas niveleve tregon një shpërndarje të qartë të fuqisë punëtore në intervalin 401-600 euro në të gjitha komunat. Në Podujevë, ky nivel përfshin 1643 punonjës, në Dragash 520 punonjës dhe në Shtime 515 punonjës. Shuma e shpenzuar për burrat në këtë nivel pagash është më e lartë në të gjitha rastet, duke përforcuar pabarazinë gjinore në shpërndarjen e fondeve publike. Në nivelin më të ulët të pagave (201-400 euro), numri




³⁹ Komuna e Podujevës. (2024). *Buxheti 2025-2027 i miratuar në Kuvend*. Komuna e Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/10/Buxheti-2025-27-i-miratuar-ne-Kuvend.pdf>

⁴⁰ Komuna e Shtimes. (2024). *Buxheti i përgjithshëm gjinor*. Komuna e Shtimes. <https://kk.rks-gov.net/shtime/wp-content/uploads/sites/28/2023/06/Buxheti-i-pergjithshem-gjinor-1.pdf>

⁴¹ Komuna e Dragashit. (2023). *Buxheti gjinor 2023*. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Buxheti-Gjinor-2023.pdf>


i grave është dukshëm më i vogël se i burrave, çka tregon se burrat mbizotërojnë edhe në pozitave më të ulëta të pagave.

Në aspektin e subvencioneve dhe shërbimeve të ofruara, Podujeva⁴² ka pasur një rritje të



konsiderueshme të buxhetit të alokuar për subvencione nga 860 mijë euro në vitin 2022 në 1.81 milionë euro të planifikuara për vitin 2025. Numri total i përfituesve është rritur nga 1114 në vitin 2022 në 1700 në vitin 2025, me një rritje më të shpejtë të përfituesve gra. Ndërkohë, në Dragash⁴³, numri i përfituesve të subvencioneve ka mbetur pothuajse i pandryshuar, me një mesatare prej 109-120 përfitues

në vit, ndërsa buxheti për subvencione ka pësuar rënie në vitin 2023. Në Shtime, buxheti për subvencione është rritur ndjeshëm, nga 150 mijë euro në vitin 2022 në 350 mijë euro të planifikuara për vitin 2024, ndërsa numri i përfituesve ka kaluar nga 90 në vitin 2022 në 300 në vitin 2024. Kjo tregon se Shtimja dhe Podujeva po investojnë më shumë në mbështetjen e përfituesve, ndërsa Dragashi⁴⁴ duket të ketë një qasje më të kufizuar ndaj subvencioneve.



Sektori i subvencioneve të ndara sipas fushave specifike tregon një rritje të financimeve për bujqësinë dhe administratën në Podujevë, ku fondet për bujqësinë janë rritur nga 50 mijë euro në vitin 2022 në 80 mijë euro në vitin 2023. Në sektorin e arsimit dhe administratës, ka pasur një rritje të ndjeshme të fondeve për gratë, megjithatë burrat vazhdojnë të marrin pjesën më të madhe të subvencioneve. Në sektorin e

⁴² Komuna e Podujevës. (2024). *Buxheti 2025-2027 i miratuar në Kuvend*. Komuna e Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/10/Buxheti-2025-27-i-miratuar-ne-Kuvend.pdf>

⁴³ Komuna e Shtimes. (2024). *Buxheti i përgjithshëm gjinor*. Komuna e Shtimes. <https://kk.rks-gov.net/shtime/wp-content/uploads/sites/28/2023/06/Buxheti-i-pergjithshem-gjinor-1.pdf>

⁴⁴ Komuna e Dragashit. (2023). *Buxheti gjinor 2023*. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Buxheti-Gjinor-2023.pdf>

kulturës, rinisë dhe sportit, ndarja e fondeve ka mbetur e barabartë midis burrave dhe grave në shumën 35 mijë euro secili, duke treguar një qasje më të balancuar.

Në përfundim, analizat tregojnë se ndërsa numri i grave në punësim dhe përfitimi i subvencioneve po rritet, diferenca gjinore në paga dhe shpërndarjen e fondeve mbetet ende e theksuar. Komunitet si Podujeva dhe Shtime kanë bërë përparime të dukshme në rritjen e pjesëmarrjes së grave, ndërsa Dragashi ka pasur ndryshime më të vogla në këtë drejtim. Pavarësisht investimeve të mëdha në subvencione, shpërndarja gjinore e fondeve mbetet e pabarabartë, me burrat që marrin ende më shumë financime. Për të siguruar një zhvillim të barabartë dhe të drejtë, është e nevojshme të merren masa të mëtejshme për të balancuar pagat dhe për të siguruar që gratë të kenë qasje të barabartë në financimet publike.

Analizë Krahase: Punësimi, Pagat dhe Subvencionet në Podujevë, Shtime dhe Dragash⁴⁵

Krahësimi i Punësimit dhe Barazisë Gjinore në Paga

Podujeva ka numrin më të lartë të stafit, por Shtimja është komuna e vetme që ka arritur barazinë gjinore në pagat mesatare. Dragashi ka nivelin më të ulët të përfshirjes së grave.

Komuna	Numri Total i Stafit (Viti i Fundit)	Numri i Grave	Paga Mesatare për Gratë (€)	Paga Mesatare për Burrat (€)	Përfaqësimi i Grave (%)
Podujevë	2,045	1,013	8,723	8,682	49.5
Shtime	711	365	7,880	7,880	51.3
Dragash	758	130	6,923	6,886	17.1

Krahësimi i Strukturës së Pagave sipas Niveleve

Në të tre komunat, burrat dominojnë në kategorinë me pagë të lartë (mbi 600 €), ndërsa gratë janë më të përqendruara në kategoritë me pagë të ulët dhe të mesme. Shtimja ka përfaqësimin më të mirë të grave në kategorinë 401-600 €.

Niveli i Pagave (€)	Podujevë (Gratë/Burra)	Shtime (Gratë/Burra)	Dragash (Gratë/Burra)
201-400	62/230	54/65	30/130
401-600	801/842	279/236	95/431
600+	47/62	32/45	5/49

Krahësimi i Subvencioneve dhe Përfitimeve sipas Gjinive

⁴⁵ Komuna e Podujevës. (2024). *Buxheti 2025-2027 i miratuar në Kuvend*. Komuna e Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/10/Buxheti-2025-27-i-miratuar-ne-Kuvend.pdf>; Komuna e Shtimes. (2024). *Buxheti i përgjithshëm gjinor*. Komuna e Shtimes. <https://kk.rks-gov.net/shtime/wp-content/uploads/sites/28/2023/06/Buxheti-i-pergjithshem-gjinor-1.pdf>; Komuna e Dragashit. (2023). *Buxheti gjinor 2023*. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Buxheti-Gjinor-2023.pdf>

Podujeva ka buxhetin më të lartë total për subvencione, por Shtimja ka përfshirjen më të lartë të grave si për nga numri i përfituesve ashtu edhe për nga shuma financiare. Dragashi ka pabarazinë më të theksuar.

Komuna	Numri Total i Përfituesve (Viti i Fundit)	Numri i Grave	Numri i Burrave	Buxheti për Gratë (€)	Buxheti për Burra (€)
Podujevë	1,700	830	870	850,000	960,000
Shtime	300	200	100	233,333	116,667
Dragash	120	40	80	40,000	60,000

Analiza e Dëgjimeve Buxhetore

Ky kapitull analizon pjesëmarrjen gjinore në dëgjimet buxhetore në Podujevë, Shtime dhe Dragash për vitin 2025. Analiza tregon dallimet mes komunave në angazhimin e grave dhe sfidat që hasen në sigurimin e një përfaqësimi të barabartë. Gjithashtu, vlerësohen kërkesat dhe reagimet e komunave ndaj shqetësimeve të ngritura nga gratë gjatë dëgjimeve publike.

Raportet mbi dëgjimet buxhetore për vitin 2025⁴⁶ në komunat e Podujevës, Shtimes dhe Dragashit tregojnë dallime të dukshme në pjesëmarrjen gjinore dhe përfshirjen e grave në proceset vendimmarrëse. Në **Komunën e Podujevës**, nga gjithsej **121 qytetarë**, vetëm **18 gra** morën pjesë, apo vetëm **15%** të pjesëmarrësve. Kjo përqindje e ulët reflekton një angazhim të kufizuar të grave dhe sugjeron nevojën për politika që nxisin përfshirjen më aktive të tyre në konsultime publike.

Në **Komunën e Shtimes**, gjatë dëgjimeve për **Kornizën Afat-Mesme dhe Buxhetin Vjetor (2025-2027)**, morën pjesë **233 qytetarë**, ku vetëm **21 gra** (rreth **9%**) ishin të pranishme. Ky rezultat shfaq një mungesë të theksuar të përfaqësimit gjinor, pavarësisht se qytetarët shtruan mbi **240 kërkesa**, duke dëshmuar një interes të lartë publik, por me përfaqësim të pabarabartë.

Në të kundërt, **Komuna e Dragashit** paraqet një **shembull pozitiv**. Në dëgjimet për **Buxhetin Vjetor**, morën pjesë **93 qytetarë**, nga të cilët **54 gra** (rreth **58%**), duke treguar një përkushtim të qartë për përfshirjen e grave në proceset buxhetore. Kjo qasje sugjeron se praktikat e Dragashit mund të shërbejnë si **model për komunat e tjera**. Në total, në tri komunat e përfshira morën pjesë **447 qytetarë**, prej të cilëve **147 gra dhe vajza**, duke përfaqësuar një pjesëmarrje mesatare gjinore rreth **33%**.

Krahasimi ndërmjet komunave evidenton dallime të theksuara në përfshirjen gjinore. Ndërsa **Dragashi** shfaq një përvojë pozitive, **Podujeva** dhe **Shtimja** përballen me sfida që kërkojnë **masa konkrete** për rritjen e ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrjes gjinore.

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinorë - Podujevë

Analiza e raportit të dëgjimeve buxhetore për projekt-buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2025

Pjesëmarrja Qytetare dhe Përfaqësimi Gjinor

Në dëgjimet buxhetore kanë marrë pjesë gjithsej 121 qytetarë, nga të cilët 103 burra dhe vetëm 18 gra. Kjo përqindje e ulët e pjesëmarrjes së grave (rreth 15%) tregon për një angazhim të kufizuar të grave në proceset vendimmarrëse për buxhetin komunal.

⁴⁶ **Komuna e Podujevës**. (2024). *Raporti i dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025*. Komuna e Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/10/Raporti-i-degjimeve-buxhetore.pdf>; **Komuna e Shtimes**. (2024). *Raporti i dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025*. Komuna e Shtimes. <https://kk.rks-gov.net/shtime/wp-content/uploads/sites/28/2024/09/Raporti-i-degjimeve-buxhetore.pdf>; **Komuna e Dragashit**. (2023). *Raporti i dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025*. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Raporti-i-degjimeve-buxhetore.pdf>

Përpunimi dhe Vendimmarrja mbi Kërkesat

Gjatë dëgjimeve janë shtruar gjithsej 181 kërkesa, të cilat janë kategorizuar si më poshtë:

- 95 kërkesa të pranuar (52%),
- 73 kërkesa të refuzuara (40%),
- 13 kërkesa të adresuara në institucione të tjera (8%).

Përfaqësimi dhe Pjesëmarrja – Pranuar Koment: Gratë kanë qenë aktive në diskutime, duke përfaqësuar organizata lokale, biznese dhe këshillat e lagjeve.

Çështjet e Diskutuar nga Gratë:

- **Investime në çerdhe dhe edukimin parashkollor – Pranuar**
Koment: Është planifikuar përfshirja në buxhetin 2025.
- **Shërbime sociale për gratë në nevojë ekonomike – Pjesërisht pranuar**
Koment: Janë parashikuar fonde të kufizuara për këtë sektor.
- **Përmirësim i ndriçimit publik për sigurinë e grave – Pranuar**
Koment: Projekti është përfshirë në planin e infrastrukturës.
- **Mbështetje për gratë ndërmarrëse – Pranuar pjesërisht**
Koment: Komuna ka të dedikuara fonde për këtë program në 2025.

Kontributi i Grave në Propozimet për Buxhetin:

- **Rritje e financimeve për arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale – Pranuar**
- **Fond për viktimat e dhunës në familje – Pjesërisht pranuar**
Koment: Fondi do të mbështetet përmes projekteve partnere.
- **Subvencione për qendrën e biznesit për gratë fermere – Refuzuar**
Koment: Kjo kërkesë do të realizohet nëpërmjet ndërtimit të tregut të ri;
- **Propozimi për program trajnimi për gratë në zonat rurale – Pranuar**
Koment: Është përfshirë në diskutimet finale dhe ka marrë mbështetje për zbatim në 2025.

Tabela e kërkesave dhe përgjigjeve në dëgjimet buxhetore – Komuna e Podujevës 2025

Kategoria	Kërkesa	Statusi	Koment
Përfaqësimi dhe Pjesëmarrja	Gratë aktive në diskutime dhe përfaqësim	Pranuar	Gratë përfaqësuan organizata lokale, biznese dhe këshillat e lagjeve.
Investime në çerdhe dhe edukim parashkollor	Përfshirje në buxhetin 2025	Pranuar	Planifikuar në buxhetin 2025.
Shërbime sociale për gratë në nevojë ekonomike	Fonde të kufizuara për sektorin	Pjesërisht pranuar	Janë parashikuar fonde të kufizuara.
Përmirësimi i ndriçimit publik	Projekt për sigurinë e grave	Pranuar	Përfshirë në planin e infrastrukturës.

Mbështetje për gratë ndërmarrëse	Fonde për programin 2025	Pjesërisht pranuar	Komuna ka dedikuar fonde për këtë program.
Rritje financimesh për arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale	Përfshirë në buxhet	Pranuar	-
Fond për viktimat e dhunës në familje	Mbështetje përmes projekteve partnere	Pjesërisht pranuar	Fondi do të mbështetet përmes projekteve partnere.
Subencionimi i qirasë për qendrën e shitjes për gratë fermere	Shtyrë për shqyrtim në vitin 2026	Refuzuar	Kjo kërkesë është shtyrë për vitin 2026, kur do të ndërtohet hapësira e tregut.
Program trajnimi për gratë në zonat rurale	Përfshirje në diskutimet finale	Pranuar	Mbështetje për zbatim në 2025.

Buxheti i Përgjegjshëm Gjinator - Shtime

Analiza e dëgjimit buxhetor me grupet e nën përfaqësuar në Komunën e Shtimes (2025-2027)

Pjesëmarrja Qytetare dhe Përfaqësimi Gjinator

Në dëgjimet buxhetore (Korniza Afat-Mesme dhe Buxheti Vjetor) kanë marrë pjesë gjithsej 233 qytetarë, nga të cilët 212 burra dhe vetëm 21 gra. Kjo përqindje e ulët e pjesëmarrjes së grave (rreth 9%) tregon për një angazhim të kufizuar të grave në proceset vendimmarrëse për buxhetin komunal. Gjatë dëgjimeve janë shtruar mbi 240 kërkesa.⁴⁷

Barazia Gjimore dhe Fuqizimi i Grave:

- Një nga temat kryesore ishte pjesëmarrja e grave në buxhetimin gjinator dhe ndikimi i tij në financimet publike. Përfshirja aktive e grave në procesin e buxhetimit ndikon pozitivisht në shërbime si transporti për fëmijë, hapësirat publike, përmirësimi i shkollave, shëndetësia dhe siguria publike.
- Komuna ka mbështetur një numër të grave përmes projekteve zhvillimore, përfshirë ndihmë për mjete bujqësore dhe projekte sipërmarrëse, duke u zotuar për një balancë gjimore më të mirë në ndarjen e fondeve publike.

Pengesat për Pjesëmarrjen e Grave në Sektorin Publik:

- Mungesa e përfaqësimit të grave në pozita udhëheqëse u identifikua si një problem serioz, i ndikuar nga:
- Mungesa e një mjedisi të favorshëm për avancimin profesional.
- Mungesa e çerdheve, duke ndikuar në largimin e grave nga tregu i punës.

⁴⁷ **Komuna e Podujevës.** (2024). *Raporti i dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025*. Komuna e Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/10/Raporti-i-degjimeve-buxhetore.pdf>; **Komuna e Shtimes.** (2024). *Raporti i dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025*. Komuna e Shtimes. <https://kk.rks-gov.net/shtime/wp-content/uploads/sites/28/2024/09/Raporti-i-degjimeve-buxhetore.pdf>; **Komuna e Dragashit.** (2023). *Raporti i dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025*. Komuna e Dragashit. <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/06/Raporti-i-degjimeve-buxhetore.pdf>

- Si zgjidhje, komuna ka shpalosur planin për ndërtimin e më shumë çerdheve për të mbështetur gratë në kombinimin e punës me përgjegjësitë familjare.

Subvencionet për Fermerët dhe Gratë Sipërmarrëse:

- Gjatë dëgjimit u ngrit shqetësimi për mungesën e mbështetjes financiare për gratë fermere dhe sipërmarrëse. Një përfaqësuese ndau përvojën e saj duke theksuar se nuk kishte përfituar subvencione në dy vitet e fundit.
- Në përgjigje, komuna sqaroi se ndarja e subvencioneve bëhet sipas kritereve specifike për të garantuar shpërndarjen e barabartë të fondeve dhe u zotua për një rishikim të politikave për mbështetje më të drejtë për gratë sipërmarrëse.

Kategoria	Përmbajtja
Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave	Pjesëmarrja e grave në buxhetimin gjinor ndikon pozitivisht në shërbime si transporti për fëmijë, hapësirat publike, përmirësimi i shkollave, shëndetësia dhe siguria publike.
Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave	Komuna ka mbështetur gratë përmes projekteve zhvillimore, duke përfshirë ndihmë për mjete bujqësore dhe projekte sipërmarrëse, me qëllim balancën gjinore në ndarjen e fondeve publike.
Pengesat për Pjesëmarrjen e Grave në Sektorin Publik	Mungesa e përfaqësimit të grave në pozita udhëheqëse për shkak të mungesës së një mjedisi të favorshëm për avancimin profesional.
Pengesat për Pjesëmarrjen e Grave në Sektorin Publik	Mungesa e çerdheve ndikon në largimin e grave nga tregu i punës.
Pengesat për Pjesëmarrjen e Grave në Sektorin Publik	Komuna ka shpalosur planin për ndërtimin e më shumë çerdheve për të mbështetur gratë në kombinimin e punës me përgjegjësitë familjare.
Subvencionet për Fermerët dhe Gratë Sipërmarrëse	U ngrit shqetësimi për mungesën e mbështetjes financiare për gratë fermere dhe sipërmarrëse. Një përfaqësuese ndau përvojën e saj duke theksuar se nuk kishte përfituar subvencione në dy vitet e fundit.
Subvencionet për Fermerët dhe Gratë Sipërmarrëse	Komuna sqaroi se ndarja e subvencioneve bëhet sipas kritereve specifike për të garantuar shpërndarjen e barabartë të fondeve dhe u zotua për një rishikim të politikave për mbështetje më të drejtë për gratë sipërmarrëse.

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor - Dragash

Analiza mbi kërkesat dhe përfshirjen e grave në planifikimin buxhetor të Komunës së Dragashit (2025-2027)

Pjesëmarrja Qytetare dhe Përfaqësimi Gjinor

Në dëgjimet buxhetore (Buxheti Vjetor) kanë marrë pjesë gjithsej 93 qytetarë, nga të cilët 39 burra dhe 54 gra. Kjo përqindje e lartë e pjesëmarrjes së grave (rreth 58%) tregon për një angazhim të fokusuar për të përfshirë gratë dhe vajzat në proceset buxhetore.

Shëndeti dhe Kujdesi për Gratë:

- **Subvencionimi i grave të prekura nga kanceri – Pranuar**
Shuma prej 500 euro për secilën grua për të lehtësuar barrën ekonomike.
- **Sigurimi i Pap Testit falas – Pranuar**
Sigurimi i qasjes më të lehtë në diagnostikim dhe parandalim.
- **Përmirësimi i shërbimeve gjinekologjike – Pranuar**
Përmirësimi i qasjes në shërbimet bazë shëndetësore.
- **Mungesa e stafit në sallën e lindjes – Pjesërisht pranuar**
Komuna premtoi angazhim për të plotësuar mungesat, por pa afate të qarta.

Kujdesi Social dhe Përkujdesja për Fëmijët:

- **Hapja e çerdheve publike dhe subvencionimi i kujdesit për fëmijët – Pranuar**
Çerdhja në qytetin e Dragashit pritet të bëhet funksionale, dhe qendrat komunitare janë në proces transformimi për t'u shërbyer si çerdhe.
- **Sigurimi i një qendre për gratë e dhunuara dhe të divorcuara – Pjesërisht pranuar**
Projekt i përfshirë në programin "Wintegra" të financuar nga BE, por kërkohet mbikëqyrje për zbatimin efektiv.

Transporti dhe Lëvizshmëria për Gratë:

- **Sigurimi i transportit të sigurt për gratë në zonat rurale – Refuzuar**
Komuna deklaroi se kjo është çështje e nivelit qendror (Ministria për Infrastrukturë dhe Transport).

Fuqizimi Ekonomik i Grave:

- **Krijimi i panairove për promovimin e produkteve – Refuzuar**
Komuna premtoi shqyrtimin e mundësisë për organizimin e panairit në të ardhmen.
- **Hapja e një fabrike për punësimin e grave – Refuzuar**
U sqarua se çështja është e sektorit privat, por komuna do të shqyrtojë lehtësira për bizneset që punësojnë gra.

Kategoria	Veprimi	Statusi	Detaje/Komente
Shëndeti dhe Kujdesi për Gratë	Subvencionimi i grave të prekura nga kanceri	Pranuar	Shuma prej 500 euro për secilën grua për të lehtësuar barrën ekonomike.
	Sigurimi i Pap Testit falas	Pranuar	Sigurimi i qasjes më të lehtë në diagnostikim dhe parandalim.
	Përmirësimi i shërbimeve gjinekologjike	Pranuar	Përmirësimi i qasjes në shërbimet bazë shëndetësore.
	Mungesa e stafit në sallën e lindjes	Pjesërisht pranuar	Komuna premtoi angazhim për të plotësuar mungesat, por pa afate të qarta.
Kujdesi Social dhe Përkujdesja për Fëmijët	Hapja e çerdheve publike dhe subvencionimi i kujdesit për fëmijët	Pranuar	Çerdhja në qytetin e Dragashit pritet të bëhet funksionale; qendrat komunitare janë në proces transformimi.
	Sigurimi i një qendre për gratë e dhunuara dhe të divorcuara	Pjesërisht pranuar	Projekt i përfshirë në programin "Wintegra" të financuar nga BE, kërkohet mbikëqyrje për zbatimin.
Transporti dhe Lëvizshmëria për Gratë	Sigurimi i transportit të sigurt për gratë në zonat rurale	Refuzuar	Komuna deklaroi se kjo është çështje e nivelit qendror (Ministria për Infrastrukturë dhe Transport).
Fuqizimi Ekonomik i Grave	Krijimi i panairove për promovimin e produkteve	Refuzuar	Komuna premtoi shqyrtimin e mundësisë për organizimin e panairit në të ardhmen.
	Hapja e një fabrike për punësimin e grave	Refuzuar	U sqarua se çështja është e sektorit privat, por komuna do të shqyrtojë lehtësira për bizneset që punësojnë gra.

Konkluzionet

Pjesëmarrja e grave në Dëgjimet Buxhetore:

- Pjesëmarrja e grave në dëgjimet buxhetore është shumë e ulët, në mesataren e tri komunave del se 33% e pjesëmarrësve, janë gra (*Podujeva, 15%; Shtime, 9% dhe Dragashi 58%*).
- Përkundër se dy komuna (Shtime dhe Dragash), kishin planifikuar dëgjime të veçanta buxhetore me gratë dhe vajzat, ato nuk kishin zhvilluar një plan të shtrirjes për siguruar pjesëmarrje dhe përfshirje më të gjerë.
- Gratë kanë kontribuar kryesisht në diskutime lidhur me investimet për arsimin, shërbimet sociale dhe mbështetje për gratë ndërmarrëse, por një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të grave janë refuzuar ose janë pranuar pjesërisht.

Përfaqësimi gjinor në pozita politike dhe administrative:

- Komunitet si Podujeva kanë bërë përparime pozitive në përfaqësimin e grave në pozita politike, duke arritur një përfaqësim të moderuar (42.85%) në krahasim me Shtimen (28.57%) dhe Dragashin (20%). Megjithatë, gratë ende mbeten të nën-përfaqësuar në pozita udhëheqëse dhe administratën publike.

Pabarazia në paga dhe subvencione:

- Pabarazia gjinore është e evidente në shpërndarjen e pagave dhe subvencioneve. Gratë mbeten të përqendruara në nivelet e ulëta të pagave dhe përfitojnë më pak nga subvencionet, përpos disa përpjekjeve për mbështetje më të drejtpërdrejtë në disa sektorë si bujqësia dhe arsimi.
- Në disa komuna, si Podujeva, ka përmirësim në nivelin e pagave të grave, por shpërndarja e fondeve publike si investimet, shërbime dhe subvencione mbetet ende e pa barabartë, dhe gratë vazhdojnë të përballen me barrierat që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë në tregun e punës dhe mundësitë financiare.

Përfshirja e grave në programet dhe projektet e zhvillimit ekonomik lokal:

- Ndonëse ka pasur përparime të dukshme, përfaqësimi i grave në sektorin e biznesit, por përkrahje mbetet ende e pa barabartë. Në disa raste edhe pas kërkesave në këto komuna, gratë nuk kanë siguruar financime komunale për bizneset, duke krijuar një hendek në mundësitë për zhvillimin e grave sipërmarrëse.
- Sektori i bujqësisë dhe i ndërmarrësisë ka qenë i paqartë në ndarjen e fondeve, dhe shumë gra nuk kanë mundur të përfitojnë në mënyrë të drejtë nga mundësitë financiare, kjo edhe për shkak të programit të skemave të mbështetjes (specifikat e thirrjeve dhe pajisjeve).

Rekomandimet

Përfshirja më aktive e grave në Dëgjimet Buxhetore:

- Komunitet duhet të ndërmarrin hapa për të inkurajuar pjesëmarrjen më të madhe të grave në dëgjimet buxhetore dhe proceset vendimmarrëse. Kjo duke krijuar mundësi për angazhimin e grave nga organizatat lokale, shoqatat dhe sektorët e tjerë që mund të kontribuojnë me kërkesa dhe propozime për buxhetin komunal.
- Shtimi i platformave të komunikimit dhe mundësive për diskutime dhe vlerësime do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe mundësive të përfshirjes aktive të grave.

- Zhvillimi i planeve të shtrirjes (out-reach plan) për të marrë në konsideratë të kufizimet dhe përdorur qasje të fokusuara për zgjerimin e angazhimit të grave;
- Përfshirja aktive e anëtareve të kuvendeve komunale, në dizajnimin e programeve dhe proceset buxhetore që prekin barazinë gjinore, përfshirë edhe planifikimet zhvillimore dhe strategjitë komunale.

Rritja e përfaqësimit të grave në pozita udhëheqëse dhe administratën publike:

- Komunat duhet të sigurojnë që gratë të kenë mundësi të barabarta për të avancuar në pozita udhëheqëse, duke zbatuar politika mbështetëse dhe trajnime që ofrojnë mundësi për zhvillimin e aftësive udhëheqëse.
- Mund të krijohen masa afirmative dhe infrastrukturë mbështetëse për gratë që janë të angazhuara në aktivitete politike dhe administrative, siç janë mentorimi dhe mbështetje financiare për gratë që dëshirojnë të zhvillojnë karrierën e tyre politike.

Buxhetimi i barabartë dhe përmirësimi i shpërndarjes së fondeve:

- Komunat duhet të bëjnë një vlerësim të detajuar të shpërndarjes gjinore të fondeve dhe të krijojnë kritere të qarta dhe të drejta për përfituesit, duke siguruar që gratë të kenë mundësi të barabarta për të përfituar nga burimet financiare të komunës.
- Ndarja e fondeve për përfitues të subvencioneve duhet të bëhet në mënyrë të barabartë, duke mbështetur gratë, veçanërisht ato në sektorët më të nën-përfaqësuar si bujqësia dhe industria e vogël.

Përmirësimi i mbështetjes për gratë sipërmarrëse dhe fermeret:

- Komunat duhet të zhvillojnë politika dhe programe që mbështesin gratë në sipërmarrjen e bizneseve dhe në sektorin bujqësor, duke ofruar trajnime, subvencione dhe mundësi për rritjen e kapaciteteve të grave.
- Sektori i mbështetjes për bizneset dhe fermerët duhet të krijohet me një fokus të qartë për gratë, duke mundësuar që ato të mund të zhvillojnë mundësi të qëndrueshme biznesi dhe të përfitojnë nga burimet financiare të komunave.

Investime në infrastrukturën mbështetëse për gratë:

- Komunat duhet të investojnë në shërbime dhe infrastrukturë që mbështesin gratë, siç janë çerdhet, qendrat për gratë e dhunuara dhe shërbimet e kujdesit për fëmijët. Këto masa do të sigurojnë që gratë të kenë mundësi për të balancuar angazhimin në punë dhe përgjegjësitë familjare, duke krijuar një mjedis të favorshëm për avancimin e tyre në tregun e punës dhe në pozita udhëheqëse.

Përmirësimi i politikave të mbështetjes për gratë në rrethana të ndryshme sociale dhe ekonomike:

- Komunat duhet të rishikojnë dhe të krijojnë politika të drejta dhe të balancuara për të mbështetur gratë që janë të prekura nga varfëria, dhuna në familje dhe diskriminimi. Këto politika duhet të përfshijnë subvencione për gratë sipërmarrëse, ndihmë për gratë në nevojë dhe mundësi për rritjen e përfshirjes së grave në aktivitete zhvillimore dhe ekonomike.

Lista e Referencave

1. **Agjencia për Barazi Gjinore. (2020).** Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024. Agjencia për Barazi Gjinore. [Link](#)
2. **Demokracia për Zhvillim (D4D). (2022).** Përtej barazisë numerike: Fuqizimi i grave anëtare të kuvendeve të komunave në qeverisje lokale. Demokracia për Zhvillim. [Link](#)
3. **Gazeta Zyrtare. (2015).** Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Kuvendi i Kosovës. [Link](#)
4. **Komisioni Evropian. (2023).** Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023. Komisioni Evropian. [Link](#)
5. **Komuna e Dragashit. (2023).** Buxheti gjinor 2023. Komuna e Dragashit. [Link](#)
6. **Komuna e Dragashit. (2024).** Kalendari i dëgjimeve. Komuna e Dragashit. [Link](#)
7. **Komuna e Dragashit. (2025).** Raporti i dëgjimeve 2025. Komuna e Dragashit. [Link](#)
8. **Komuna e Podujevës. (2024).** Buxheti 2025-2027 i miratuar në Kuvend. Komuna e Podujevës. [Link](#)
9. **Komuna e Podujevës. (2024).** Buxheti 2025-2027 i miratuar në Kuvend. Komuna e Podujevës. [Link](#)
10. **Komuna e Podujevës. (2024).** Kalendari i dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për buxhetin e vitit 2025. Komuna e Podujevës. [Link](#)
11. **Komuna e Podujevës. (2025).** Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt-buxhetin e komunës për vitin 2025.
12. **Komuna e Shtimes. (2024).** Buxheti i përgjithshëm gjinor. Komuna e Shtimes. [Link](#)
13. **Komuna e Shtimes. (2024).** Postim në faqen zyrtare, kalendari i dëgjimeve buxhetore [Postim në Facebook]. Facebook. [Link](#)
14. **Komuna e Shtimes. (2025).** Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar: gra, të rinj, pensionistë, persona me aftësi të kufizuara.
15. **Kosovo Local Government Institute. (2022).** Hulumtimi: Pasqyrimi i përbërjes së Kuvendeve Komunale. Kosovo Local Government Institute. [Link](#)
16. **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. (2024).** Raporti i Performancës Komunale 2023. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. [Link](#)
17. **Ministria e Pushtetit Lokal. (2023).** Vlerësimi i kapaciteteve të strukturave komunale për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore. Ministria e Pushtetit Lokal. [Link](#)
18. **Ministria e Pushtetit Lokal. (2024)** Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar – Qershor 2024 [Link](#)
19. **Ministria e Pushtetit Lokal. (2024).** Raporti për vlerësimin e transparencës (janar – dhjetor) 2023. Ministria e Pushtetit Lokal. [Link](#)